

Alexander Jokic

Pasoja e Intervenimit në Kosovë

Përkthyer nga Muhamet Brajshori

Hyrje

Ne këtë kapitull të fundit të librit tone dedikuar çështjes së “Intervenimit Humanitar”, do e beje një përshkrim mbi atë se cila është pasoja dhe rezultati i intervenimit në Kosovë. Posaçërisht do fokusohem në ngjarjet që kanë ndodhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së “paqes” së Kumanovës mes NATO-s dhe Ushtrisë Jugosllave, e cila lejonte hyrjen e forcave të KFOR-it në Kosovë. Çështjet që duhet të analizohen dhe shikohen në mënyre të kujdesshme nga aspekti filozofik kanë të bëjnë me gjuhën për të përshkruar ngjarje, politika, dhe rekomandime për ndryshimet në rajon.

Kjo gjuhë në shumë mënyra është duke shkatërruar realitetin në terren (rajon) dhe në bote, synimi i arritjes së qartësisë duhet të ndihmojë tendencat në formulimin e “një zgjidhje kuptimore për stabilitetin afatgjatë dhe paqen në rajon”. Diçka e pabesueshme, por unë do të dëshmoj se paqja duhet të jetë synimi kryesor i gjithë aktoreve të përfshirë. Prandaj do filloj me përshkrimin e nevojës për zhvillimin e një etike të veprimtarit ndërkombëtarë, pasuar nga ekzaminimi i “lojërave të fjalëve” (*word games*) çka mundet të ndikoj në synimet për paqe, dhe në pjesën e fundit do të propozojë një zgjidhje çka përfshin me shumë pjesë, jo vetëm Kosovën.

Etika e Veprimit Paqësore

Çdo kund kam argumentuar se ka të përbashkët mes veprimtarit, ideologjisë dhe formave kryesore të vendosa si pjesë të diskursit mbi konfliktet ballkanike. Këtu do i shpjegojë shkurtimisht pikat e përbashkëta në mënyre që të vendosi një kontekst për diskutim në pjesën tjetër të kapitulli.

Në përshkrimin e veprimtareve me vijnë ndërmend disa terma si “kuptimi i mirë” (*well-meaning*), “gati për sakrifice” (*ready to sacrifice*) apo “paqë dashje” (*peace-loving*). Kjo do të thotë se motivimi i tyre nuk është mirë vetëm në sensin e thjeshtë ordinare që aktiviteti në vetvete është i mirë, apo merret me qene mirë, por është mirë sepse

objektivat e drejtojnë aktivitetin, te cilat padyshim janë te mira (paqja, de-nuklearizimi apo drejtat e njeriut). Ky motivim I dale nga veprimtaret ngriti sensitivitet mbi te keqen qe ekziston ne bote. Pa ketë sensitivitet këtu nuk do te kishte ndonjë aktivitet. Motiviet e tyre, nuk janë vetëm mire kur aktivitetet e tyre kthehen ne retrospektive, por motivimi është mire ne sensin e plote qe është vet e mira. Motivimi I tyre nuk është ne vazhdimësi I mire, por gjithsesi, është thëne (qëllimi) te fokusohet drejt te mirës.

Ky grumbull motivesh është ne një pjese te fundit te preokupimit te veprimtareve me çështje qe ne mënyre strikte flasin për një shqetësim te drejtpërdrejt për ta. Veprimtarja nuk është duke luftuar për diçka për vetveten, por ajo është e angazhuar sepse s'mund te vuaj keq nga te tjerët (e keqe e jashtme apo nga jashtë). Ky pranim i mungesës se interesave direkte te veprimtares ne çështje te angazhimit te saj, tregon qe kjo *peculiar impetus* behet ajo qe duhet te jete puro morale ne natyrën e saj. Kjo është çka ne mënyre ekzakte definon pozicionin e veprimtareve (ndërkombëtare).

Një shfaqje e pamjes ne baze te se cilës, për veprimtaret, jep natyrën aksiologjike te kauzës se saj për çka është duke luftuar , për çdo gjë qe është e kërkuar për te vendos atë ne një rruge te drejte qe te jete serioze dhe te jete e palëkundur ne vendimet e saja. A nuk ka pengesa për te vene qëllimin e drejte, për te mprehur çka është padyshim synimi I drejte për te cilin duhet te japësh sakrifice personale, veprimtari zotëron jo vetëm një bindje te palëkundur qe kauza është e drejte, por gjithashtu një zotërim qe asnjë konsiderim te mos vihet ne pikëpyetje. Pozicioni është me vlere te njëjte për personin qe ka përgjigjet përpara, pa pasur nevojë qe te angazhohet për kërkimin e fakteve te tjera. Është një pozicion ne mënyre te shpejte ofron përgjigje, por procedurat qe I ofrohen asaj mbeten te fshehura, pazbuluara dhe te parëndësishme. A do te thotë kjo qe nuk është duke folur ne mënyre striktë , dhe rëndësishme vetëm qe çka do gjendet dhe arrihet ne te vërtet, por çka do qe është arritur është mjaft mire- ne sensin e te qenurit mjaftueshëm? Por ndryshe prej se veprimtari motivimet I sheh si te drejta dhe te mira, a do te thotë kjo se këtu nuk është e mundur te ngritet ndonjë pikëpyetje, apo asnjë argumentim I çfarëdo lloji është e mundur ne ketë rast? Shënimi I fundit tregon një karakter ideologjik te situatës- ku ne tregtojmë ne një kontekst ku çështjet nuk funksionojnë ne anën e tyre konsumuese, apo jo si te tera.

Ideologjitë funksionojnë në mënyrë precize në këtë mënyrë: arsyet nuk janë prezantuar, dhe për çdo argumentim të ofruar, çdo gjë është e zgjidhur (para se të ngrihet në pikëpyetje). Çka është më shumë përpjekja për të sqaruar natyrën reale të çdo gjeje-kur është bërë nga një këndvështrim i pavarur, nga perspektiva e cila dështon të paracaktoj me respekt bazën filozofike të saj, është parë si rrugë për të vënë në pikëpyetje çështje që tanimë janë qarta dhe të pranuar! Ideologjitë siç dihet nuk përfshijnë debate, argumentime dhe jo pasiguri. Çka në mundemi të gjejmë është se të gjitha arsyet janë të turbulluara, disa janë të favorshme e disa nuk janë. Ky mekanizëm, së bashku me veprimtarinë dhe ideologjitë, është megjithatë e përhapur plotësisht me disa fjalë në diskursin e tanishëm mbi krizat e gjata në Ballkan. Funkcioni gjuhësor është mode edhe pse rëndësia mbetet në nivelin deklarativ. Asnjë diskutim, asnjë shoshitje, asnjë argumentim *pro et contra* nuk janë të fshehura, s'ka asnjë kompromis apo tërheqje, por vetëm një betejë për kauzën me të drejtë.

Kjo është baza për shumë në lojën e fjalëve çka mundet shumë lehtë të lëkund edhe me të mirin në drejtimin e shkaktimit të një demisë sesa të bëjë diçka mirë. Shembuj të kësaj janë të sqaruar në kapitujt në vazhdim. Nëse e konsiderojmë termin 'revolucion demokratik' që u përdor për të shpjeguar ngjarjet e 5 tetorit të vitit 2000 në Jugosllavi, çka bëri një tranzicion nga udhëheqja 10 vjeçare e Miloshevicit në një qeveri të re. Çka do të thotë në të vërtetë revolucion demokratik dhe çka synon të tregoj? Në të vërtetë termi nuk shpjegon asgjë, por vetëm pasqyron aprovime përmes kuptimit pozitiv të fjalës demokraci. Një element tjetër është, fenomeni i kuptimit jo-deskriptiv (jo-sqarues) në termat kryesor. Ana tjetër është ajo që e quan Stevenson karakteri propagandistik i gjuhës së përdorur, dhe është mu kjo që nëse mirën këto elemente së bashku tregojnë lojën e gjuhës (word game). Në jetën e përditshme kjo na largon nga kuptimi i sakt, siç mund të jete financimi i legal i një pale nga një shtet i caktuar. Në një shtrirje këto lëvizje janë mohues .

Nacionalizmi Serb

Të shqyrtojmë se pari termin "Nacionalizëm serb". Kur përshkruhej kandidati i opozitës serbe Vojslav Koshtunica, përdorëshin terma si i moderuar apo vija e ashpër kur

vëzhguesit tentonin ta shpjegojeni atë. Le te shtrojmë pyetjet, çka është e gabuar me nacionalizmin serb. Askush s’do e tregoj saktësisht, por kjo është diçka seriozisht e gabueshme nëse mirët për dhënie. Neve na tregonin se Presidentin Jugosllav Miloshevic nuk duhet ta lejojmë te luaj me letrat e ndjenjës se nacionalizmit serb.

Deri ne ditën pas zgjedhje ne serbi, lideri opozitar Koshtunica, ne perëndim përshkruhej si një nationalist I moderuar serb. Çka do te thotë kjo fjale, se ai nuk është me I keq se Miloshevici, qe I takon vijës se ashpër nacionaliste. Një dite pas shout impresiv te Koshtunices ne raundin e pare zgjedhor (ai mendonte realisht qe mund te shënoje një fitore te madhe ndaj Miloshevicit), Koshtunica u vendos ne listën e nacionalistev te vijës se ashpër nga një grup me ndikim si Stratfor (Strategic Forecasting, LLC) ne një artikull me teme “Shahmati Jugosllav”, ku te tjerët ne fillim e quajtën moderuar menjëherë kërcyen ne përshkrimin e tij si një nationalist te vijës se ashpër. Një person cinik do mund te thoshte se ky transferim tregon një definicion se gjithmonë vetëm njerëzit e keqije duhet te jene ne pushtet ne Jugosllavi.

Te kthehemi te ky termi mbresëlënës “Ndjenja Nacionaliste Serbe”. Këtu duhet te jemi te kujdesshëm për kuptimin e saj, sepse kjo fjali është përdorur ne vitet e 90’ta ne kontekstin e tragjedisë jugosllave,qe ka vendos një faj kolektiv mbi popullin serb. Si duket te gjitha kombeve iu lejohet te kenë ndjenja nacionaliste, por vetëm atyre (serbeve) nuk iu lejohet. Ky term ishte përdorur si *inter alias* me “Serbinë e Madhe” ide (ideologji qe I atribuohet te gjithë serbeve) qe përfshin praktiken e largimit te gjithë jo-serbeve nga territore te caktuara. Unë e definoj “ndjenjën nacionaliste” si një shqetësim qe ka domethënie te mirën e një grupi te caktuar ne një mënyre qe jep preferenca te anëtarët e një grupi qe janë me mire sesa te tjerët. Ne rastin e popujve te Jugosllavisë para periudhës kur fitoj Koshtunica, këto ndjenja ishin lidhur kundër dy burimeve te se keqes: ndaj regjimit dhe ndaj komunitetit ndërkombëtare (posaçërisht ShBA-ve te cilat udhëheqin intervenimin e NATO-s). Ne fakt ndjenjat nacionaliste nuk kishin lidhje ne këtë kohe me ndonjë mbështetje ndaj një grupi politik, por me shume ndaj këtyre burimeve te se keqes. Për këtë nuk kishte ndonjë ndjenje nacionaliste ndaj qeverise jugosllave. Me mire, ajo ishte një anti-qëndrim, qe nga fatkeqësia dhe mizëria e qe

kaluan popujt e Ballkanit te cilët ne mënyre duhet ne fakt te zgjidhnin ne mes te këtyre dy te këqijave, një te jete I gjykuar me pak I keq.

Ne fund, do te pyesja, pse duhet Koshtunica te cilësohet si nacionalist, ne kuptimin negative te fjalës. Dy arsye janë marre gjithmonë. Se pari se ai e dënoj luftën e 1999 dhe I cilësoj bombardimet e NATO-s si “akte kriminale”.Dhe se dyti se ai nuk e njohu legjitimitetin e tribunalit te Hagës. Por bindja se NATO beri krime lufte dhe se tribunal I Hagës është një institucion politik I cili I shërben qëllimeve te njëjta sikur sanksionet dhe kampanja e NATO-s janë mendime universal ne serbi dhe rreth saj. A do e bënte kjo te gjithë ata qe mendojnë kështu ne Indi, Rusi, Kine dhe veprimtaret e anti-luftës ne ShBA dhe çdo kund, te cilësoj si nacionalist te vijës se ashpër, sigurisht qe jo.

Kthimi I Spastrimit Etnik dhe Hakmarrja vrasëse

Nëse kthehemi ne kohen pas bombardimeve te NATO-s ne Jugosllavi, ne pjesën e dyte te v.1999, pasi qe NATO hyri ne Kosove, ne u përballem me dy terma të ri qe u përdoren nga gazetaret kureshtar, analisteve politik dhe te akademikeve “Kthimi I Spastrimit Etnik” dhe “Hakmarrja Vrasëse”. Këto zëra te pafajshëm strehojnë një qëndrim te rrezikshëm për vete kënaqësi ne drejtim te një masakrimi te vërtet te civileve te panumërt.

Ne pranvere te vitit 1999 kur kombet perëndimore u përballen me njoftime ne kuptimin e plote te fjalës anektodike, se ne Kosove po ndodhin gjera jo-njerëzore, te cilat kinse janë kryer nga forcat serbe, ne verë mediat u bene tejet te qeta. Mediat vendosen te mos raportojnë për krimet e Ushtrisë çlirimtare te Kosovës (UÇK-së) ndaj jo-shqiptareve (edhe te shqiptareve jo-mysliman) te Kosovës. Ata s’kishin raportuar mbi shkatërrimet e shtëpive, fermave serbe dhe te objekteve fetare ne pronësi te kishës ortodokse serbe.

Kjo heshtje e një reagimi u be për dy arsye. Se pari se ngjarjet ne pranvere te 1999 ndodhen pas largimit te veshzgueseve ndërkombëtare ne prag te bombardimeve, ndërsa ne vere 1999 masakrat ndaj serbeve, romeve etj., ndodhen ne praninë e mbi 50 mije paqeruajtësve ndërkombëtare te dominuar nga NATO. Se dyti, titulli tregon një term, qe është ndërtuar për tu përdorur për te justifikuar ndërhyrjen ushtarake , dhe për

te vendosur qe te qëndrohet dhe te shikohen masakrat e fundit. Dhe përderisa gazetaret dhe politikanet luajnë me këto terma, fjalët e tyre do inkurajojnë masakrat.

Për ata qe mendojnë se këto terma janë te drejte, duhet t'ia kujtoj se se dallimi mes spastrimit etnik dhe kthimit te spastrimit etnik nuk ndihmon ne sqarimin e ndonjë shtate te caktuar. Përdorimi I këtyre termave është thjeshtë një indikacion i një mape precize ne kohe kur ata e shfrytëzojnë, morën se pari me interesim ngjarjet ne zhvillim. Po te kishin filluar ti kushtojnë rendësi disa ngjarjeve te hershme , mendoj për atë çka Shqiptarët e Kosovës iu bene serbeve gjate viteve te 70'ta dhe 80'ta , renditja e këtyre termave do ishte ndryshe. Ne do kishim spastrim etnik te serbeve gjate viteve te 80'ta, kthim te spastrimit etnik ndaj shqiptareve gjate 90't dhe pastaj kthim te kthimit te spastrimit etnik ndaj serbeve tani. Ndoshta storia do ishte me e komplikuar se qe është sot.

E njëjta vlen edhe për vrasjet dhe vrasjet hakmarrëse. Duke shtuar termat kthim dhe hakmarrje një bindje justifikimi është krijuar për këto akte qe drejton ne mosveprim për te tentuar ndaljen raundit te fundit te dhunës. Kjo loje fjalësh është ne veçanti e rrezikshme sepse nxit vrasje, dhune dhe shkatërrim duke fshehu mosveprimin. Leksikoni I mohimit kështu vazhdon te rritet.

Zgjidhja

A ka ndonjë zgjidhje afatgjate për dhunën ne Ballkanin ? A do vije ndonjëherë paqja dhe stabiliteti ne ketë rajon te trazuar? Unë besoj se është një shanse, dhe këtu është zgjidhja qe veprimtaret e paqes duhet ta mbështesin.

Një serbi demokratike është një mundësi për mijëra trupa amerikane te stacionuara ne Ballkan te kthehen ne shtëpi, dhe atë shume shpejt. Një zgjidhje gjithë përfshirëse për gjitha çështje te dala nga shkatërrimi I Jugosllavisë do jete lehte e arritshme me te gjithë me një prezence te vogël ushtarake ne Ballkan (një numër I vogël do qëndronin ne Maqedoni).

Shume mendojnë se Kosova është një problem kokëforte (vështire), edhe pas “revolucionit demokratik” ne Beograd. Ajo nuk është! Zgjidha me e qarte dhe e mundshme është ndarja e Kosovës ndërmjet serbeve dhe shqiptareve. Pjesa serbe e Kosovës do behej pjese e shtetit serb ndërsa pjesa tjetër e mbetur me shqiptare do pavarësohen. Shqiptarët e kane bere te qarte se nuk dëshirojnë asgjë përveç pavarësisë se Kosovës. Nëse është e mundshme, kjo dëshire duhet te realizohet. Teoria dikush merr dhe dikush do jap është e nevojshme te behet, dhe ndarja do jete rruga e vetme natyrale nga duhet te shkohet. Por çka duhet te behet për tu arritur kjo?

Se pari, mitit se Serbët ketë opSION nuk do e shohin si te pëlqyeshëm duhet te harrohet. Ne fakt shume serb, përfshire edhe anëtare te Akademisë serbe te shkencave dhe arte (SANU) dhe ne veçanti ish kryetari I Jugosllavisë Dobrica Cosic, shume gjate e kane përkrahur ketë zgjidhje. Ne vitin 1992 Cosici përkrahu ndarjen dhe anëtarësimin ne NATO- te cilin e kundërshtoj Uashingtoni. Gjate vitit 1996, kryetari I SANU-t D. Despic, neper disa intervista e proklamoje përkrahjen për ketë ide. Si duket kjo zgjidhje ka qene e favorizuar edhe nga Kisha Ortodokse Serbe. Ku do jene vijat ndarëse mes serbeve dhe shqiptareve është një çështje tjetër, por është zgjidhje fleksibile si për Serbët ashtu edhe për Shqiptarët.

Ne fakt, te binden Serbët se një ndarje specifike është mire, do jete një problem me I vogël sesa divorci I çështje se Kosovës nga Republika Srpska (pjesë konstituive e Bosnjës dhe Hercegovinës). Dhe këtu amerikanet do e bënë një lëvizje ne politiken e tyre qe do bënte qe shume djem dhe vajza te vendosura ne Kosove dhe Bosnje te kthehen ne shtëpitë e tyre. Dhe dhënia e një pakete te ndihmës financiare (si do ishte falja e borxhit te jashtëm te ish-RFSJ-se ne vlere prej \$14 bilion) dhe te një politike qe si kompensim për humbjen e një pjesë te Kosovës, Republika Srpska do I bashkohej republikës se Jugosllavisë, me çka do vendosej një stabilitet dhe paqe e qëndrueshme ne rajon për një periudhe afat-gjate dhe do zgjidhej rubikoni I Ballkanit. Një propozim do mund te behej qe OKB-ja te bëje disa provizione për mbrojtjen e e objekteve te shenjta ortodokse ne pjesën e Kosovës te dominuar nga shqiptare nga për ti mbrojtur shkatërrimi dhe mundësin e shfrytëzimit te tyre nga ana e pelegrinëve serb.

Politika e ndarjes se Kosovës dhe bashkimi te Republika Srpska me Jugosllavinë do ishte një zgjidhje e vërtet për paqen. Dhe kjo do ishte si një rezultat natyral, siç ishte bashkimi I Gjermanisë. NATO do mund te largohej nga Bosnja dhe Serbët e Republika Srpskës do ndiheshin me te sigurt nga sulmet e mundshme te boshnjakeve dhe kroateve ndaj tyre, çka do ndikonte edhe forcimi I Ushtrisë Jugosllave. Ne anën tjetër boshnjaket dhe kroatet s'do kishin për çka te frikësohen nga një qeveri demokratike ne Beograd. Njëjtte do ishte edhe ne Kosove, qe KFOR-I do mund te largohej pa kurrfarë brengje sepe një lufte mes shqiptareve dhe serbeve do ishte e pamundshme. Një kontingjent I vogël I trupave te NATO-s do kishte mundur te mbeste ne Maqedoni, mundësisht amerikane shkaku I kredibilitetit te tyre, për te mbajtur paqen dhe sigurinë atje dhe qe te pengonin ndonjë konflikt ne pjesën e dominuar nga Shqiptarët ne Maqedoni. Shqiptarët do mund te përsërisnin Kosovën atje, dhe amerikanet do ishin mbrojtja me mire për te shmangur këtë. Dhe natyrisht shpenzimet e tanishme do zvogëloheshin (rreth 3.5 bilion \$ çdo vit shpenzohen ne Kosove dhe Bosnje).

Kjo zgjidhje do provokonte rezistence ne Bosnje, por diplomatet amerikan do mund te ishin ata qe do I bindin, siç kane bere ne Dayton.